



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 846/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nenad Lazić kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Merita Shyti kandidate për Asamble Komunale nga subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Mitrovicë, paraqitur kundër Komisionerve të Vendvotimit në Mitrovicë, për shkak të paregullsive gjatë procesit zgjedhor në ditën e votim, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 13.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Merita Shyti kandidate për Asamble Komunale nga subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Mitrovicë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 12.11.2013, në Qendrat e Vendvotimeve 1102B /10R dhe 1102X/10E, kam vrejtur se është bërë ndërhyrje në rezultatet e FRK-së, ku nga tetë (8) vota më janë lënë vetëm dy vota, përkatësisht nga pesë (5) vota kam dalë me dy vota si dhe ka bashkangjitur fotot e FRK-ve që dëshmojnë ndërhyrje në vota.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtruar të Merita Shytit kandidate për Asamble Komunale nga subjektit politik (PDK), pretendohet se ka manipulim me vota të rezultatit perfundimtar, parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar prova më të cilën do të vertetohej se është kryer një veprim i tillë, andaj një pretendim i tillë u vlerësua si i pabazuar dhe ne kuptim të nenit 3.6 pika c, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në mbështetje të nenit 118.1 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

A nr. 846/2013 më datën 13.10.2013.

Kryesuesi i Panelit

Nenad Lazić

Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.

